



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 06.05.2026

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Ndërtim linje furnizim me ujë dhe energji për Qendrën e Kafshëve të Rrugës”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): *Instalime hidraulike 43328000-8.*

VLERA E FONDIT LIMIT: *4,161,315.88 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e pesëmbëdhjetë pik tetëdhjetë e tetë) Lek pa TVSH.*

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT
TË KONTRATËS**

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.3847 prot., datë 18.03.2026 të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas Buxhetit të Bashkisë të vitit 2026 të miratuar nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit;
2. Shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i punës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit: Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmime të botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe,

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Në përfundim të punës së grupit u vërejt se:

Grupi i punës u bazua në: projektin dhe preventivin për projekt zbatimin e objektit “*Ndërtim linje furnizim me ujë dhe energji për Qendrën e Kafshëve të Rrugës*” të hartuar nga grupi i punës.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur, mbështetur në rezultatin e sipërnxjerr, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 4,161,315.88 (*katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e pesëmbëdhjetë pik tetëdhjetë e tetë*) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 4 (*katër*) javë/ 28 (*njëzet e tetë*) ditë, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 (*dy*) vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 3*;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas *shtojcës 8*.

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i*

ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 39 pika 4, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e

përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit", si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar. Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 74 të tij.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa a) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit të kontratës që prokurohet. Ky kriter është vendosur për të garantuar që operatorët ekonomikë kanë përvojë në punime të natyrës së njëjtë si instalime elektrike dhe hidraulike sipas zërave të preventivit (linja kablllore, shtylla, gërmime).*

Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Punime të Përgjithshme Ndërtimi

- **N.P - 1A** Punime gërmimi në tokë;
- **NP-11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

Punime Speciale Ndërtimi:

- N.S- 8A Ndërtime parafabrikate betona arme, struktura metalike dhe druri
- NS -18A Punime topogjeodezike

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te dorëzojë licencat profesionale sipas zërave te preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër te realizoje.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente te kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne këtë forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr.42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbeshetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kategoritë janë përcaktuar në përputhje me zërat e preventivit (gërmime, instalime elektrike etj).*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	Punime gërmimi ne toke	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gërmim dheu për gropa shtyllash T/L, ne toke te bute kat I II,~1.5 m, sip tabani 1.5m2 2. Mbushje me rere per fiksimin e shtyllave b/a 3. Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km 	A (0- 20 milionë lek)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar
NP-11	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe	<ol style="list-style-type: none"> 1. F.V. Në shtyllë kabëll fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x70mm² 2. F.V. Kapikorde sy Cu-Al 70 	A(0-20 milionë lek)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date

	tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike	<ol style="list-style-type: none"> 3. Gushore izol term.4 gisht.kab 4x25-95mm² 4. F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm² 5. F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm² 6. F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm² 7. F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm² 8. F.V. Qafore linje me dy krah D = 150 mm 9. F.V.Tirantues ankeror linje e ABC ne forme pjastre 4x16-95mm² 10. F.V. Shirit tokezimi i galvanizuar St/Zn 40x4 ne kanale 11. F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm 12. F.V Fashet metalike e jashtme vetbllokuese 0.25x12x1200 mm 13. F.V. Morsete universale per shkeputes tokezimi per =9-16mm 14. Matje kontroll i Rezistences se tokezimit per nje shtyllë 		16.01.2008,i ndryshuar
NS-8	Ndërtime parafabrikate betona arme, struktura metalike dhe druri	<ol style="list-style-type: none"> 1. F.V. Shtylla te centrifuguara B. A. C25/30 per linja 0.4-10 kv, me traktor, ndermjete, NM- 9 m, 150/270/5 2. F.V. Shtylla te centrifuguara B. A. C25/30 per linja 0.4-10 kv, me traktor, ndermjete, NT- 9 m, 190/310/5 3. Struktura monolite betoni C 16/20 4. F.V. Tuba metalik D=140mm 	A(0-20 milionë lek)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar
NS 18	Punime topogjeodezike	Punime matje volume dhe piketimi te rrugës , etj...	A(0-20 milionë lek)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme,

diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- | | |
|---|---------|
| a. Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| b. Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| c. Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder | 1 (një) |

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diploma e inxhinierëve, CV dhe kontrata pune.

-Drejtuësit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

-Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

-Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin dhe paraqitjen e vetëdeklarimit sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "c". Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit (punime gërmimi dhe struktura, instalime linje energjie, piketim dhe matje). Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, elektrik, topograf, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtuësit teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme*

që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licencës”, germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- a. Minimumi 1 (një) person qe përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për Ndhmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave” nga kryqi i kuq ose organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Minimumi 1 (një) persona qe përmbush kriteret për të qenë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune” lëshuar nga organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Minimumi 1 (një) persona qe përmbush kriteret për të qenë “Koordinator për sigurinë ne pune” lëshuar nga organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d. Minimumi 1 (një) persona qe përmbush kriteret për të qenë “i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve te Ndërtimit / Inxhinier Materialeve” lëshuar nga organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin dhe paraqitjen e vetëdeklarimit sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e stafit të specializuar është vendosur në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rreziqet që paraqet kontrata objekt prokurimi, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6, germa “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, duke qenë e lidhur ngushtë dhe proporcionale me objektin e kontratës: “Ndërtim linje furnizimi me ujë dhe energji për Qendrën e Kafshëve të Rrugës”. Natyra e punimeve përfshin ndërhyrje në infrastrukturë ujësjellësi dhe energjie, procese ndërtimi në terren dhe

përdorim të materialeve specifike, të cilat paraqesin rreziqe për sigurinë në punë dhe kërkojnë kontroll të vazhdueshëm teknik.

Konkretisht:

-Eksperti për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave është i domosdoshëm për garantimin e reagimit të menjëhershëm në rast aksidentesh në kantier, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve. Prania e këtij eksperti lidhet drejtpërdrejt me nivelin e riskut që paraqesin punimet e ndërtimit.

-Përgjegjësi për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, mbështet në ligjin Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-ne Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos në këtë kontrate ku dhe numri i punonjësve të kërkuar për realizimin e saj është konsiderueshëm. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: "Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes."

-Koordinatori për Sigurinë në Pune, mbështet në ligjin Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje të cilat parashikojnë detyrimin për organizimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e masave të sigurisë në kantieret e përkohshme ose të lëvizshme.

-Specialisti për Testimin e Performancës së Materialeve / Inxhinieri i Materialeve është i nevojshëm për të garantuar kontrollin e cilësisë së materialeve dhe përputhshmërinë me specifikimet teknike të projektit dhe standardet përkatëse. Duke qenë se cilësia e materialeve ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, kjo kërkesë lidhet thellësisht me realizimin korrekt të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- | | |
|----------------------------------|-----------|
| a. Teknik elektrikist | 3 (tre) |
| b. Elektracist | 4 (katër) |
| c. Automakinist | 2 (dy) |
| d. Shofer | 1 (një) |
| e. Punëtore ndërtimi të thjeshtë | 5 (pesë) |

Punonjes Manovrator

- | | |
|-----------------|--------|
| a. Eskavatorist | 1(një) |
|-----------------|--------|

Për këta punonjës, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/privatë të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- certifikatë të sigurimit teknik e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- Për punonjësit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:
- Kontratën individuale të punës te vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale /Patente Manovrimi nga DPSHTRR. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë).
- Për punonjësit automakinist duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor. Kërkesa për dëshmitë e automakinist bazohet në Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë).
- Për punonjësit e thjeshtë, ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme.

Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në germën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për punonjësit e specializuar me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
etj				

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e punonjësve të specializuar dhe të kualifikuar është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6, germa “ç”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, të cilat lejojnë kërkimin e fuqisë punëtore dhe personelit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në mënyrë proporcionale dhe të lidhur me objektin e saj. Objekti i kontratës “Ndërtim linje furnizimi me ujë dhe energji për Qendrën e Kafshëve të Rrugës” përfshin punime të kombinuara në rrjete elektrike, rrjete ujësjellësi, punime gërmimi dhe sistemimi, transport dhe operim mjetesh. Në këtë kuadër, për çdo kategori punimesh është kërkuar një profil i dedikuar: Teknikët dhe elektrikistët janë të domosdoshëm për realizimin e instalimeve elektrike, lidhjeve dhe funksionalizimit të rrjetit të energjisë, duke garantuar zbatim sipas standardeve teknike dhe të sigurisë. Automakinistët dhe eskavatoristi (manovratori) janë të nevojshëm për operimin e mjeteve të rënda dhe realizimin e punimeve të gërmimit dhe transportit, në përputhje me kërkesat e Urdhrit nr.200, datë 16.05.2019, për pajisjen me dëshmi profesionale për përdorimin e makinerive të ndërtimit. Shoferi kërkohet për transportin e materialeve dhe logjistikën e kantierit, duke qenë pjesë integrale e zinxhirit të realizimit të punimeve. Punëtorët e thjeshtë të ndërtimit janë të nevojshëm për realizimin e proceseve ndihmëse dhe manuale, të cilat nuk mund të zëvendësohen nga mekanizimi. Kërkesa për paraqitjen e kontratave të punës dhe

dokumenteve të kualifikimit (diploma/certifikata) mbështetet në Ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”, duke garantuar që stafi i angazhuar është i trajnuar dhe i certifikuar nga institucione të licencuara. Gjithashtu, kërkesa për dëshmi të sigurimit teknik dhe certifikime profesionale synon të sigurojë që punonjësit zotërojnë aftësitë e nevojshme për të operuar në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me standardet teknike. Numri i punonjësve dhe profilet janë përcaktuar mbi bazën e analizës së projektit dhe preventivit të punimeve, si dhe në referencë të VKM nr.629, datë 15.07.2015 (manuali teknik i ndërtimit), duke reflektuar volumet e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës. Në përfundim, kriteri është lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, proporcional me volumet dhe afatin e realizimit dhe i nevojshëm për garantimin e cilësisë dhe sigurisë në zbatim.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 19 (nëntëmbëdhjetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për një periudhë 1 mujore nga data e zhvillimit të tenderit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si me poshtë:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e kërkuar.
- b. Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin dhe paraqitjen e vetëdeklarimit sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar si edhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e një fuqie punëtore minimale prej 19 punonjësish është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenin 39, pika 6, germa “ç” dhe “d”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të cilat parashikojnë mundësinë e kërimit të burimeve njerëzore të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Numri i punonjësve është përcaktuar mbi bazën e analizës teknike të projektit dhe preventivit, përllogaritjes së orëve të punës sipas VKM nr. 629/2015, natyrës së ndërhyrjeve në terren (gërmime, instalime, montime), afatit të shkurtër të realizimit (4 javë sipas grafik punimesh). Ky numër përfaqëson një minimum të domosdoshëm, që garanton realizimin paralel të proceseve të punës, respektimin e afateve kontraktuale, shmangien e vonesave dhe ndërprerjeve të punimeve. Kërkesa për paraqitjen e listëpagesave dhe vërtetimit nga administrata tatimore synon të verifikojë disponueshmërinë reale të fuqisë punëtore dhe kapacitetin organizativ të operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe lehtësisë të barrës administrative, është parashikuar që në fazën e ofertimit të kërkohet vetëm vetëdeklarimi, ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga ofertuesi i renditur i pari, në zbatim të nenit 26 të VKM nr. 285/2021. Në përfundim, kriteri është proporcional dhe i justifikuar nga analiza teknike, i lidhur drejtpërdrejt me realizimin brenda afatit të kontratës dhe i nevojshëm për garantimin e kapaciteteve reale të operatorit ekonomik.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinç mbi 5 ton me karroceri për transport shtyllash	2 cope	Pronësi ose me qira
2	Auto vinç me koshe	1 cope	Pronësi ose me qira
3	Kamion me kapacitet mbajtës 10-12 ton	1 cope	Pronësi ose me qira
4	Kamioncina me kapacitet mbajtës 1.5-5 ton	1 cope	Pronësi ose me qira
5	Eskavator me goma (mjet teknologjik)	1 cope	Pronësi ose me qira
6	Autobetoniere vetëngarkuese 1.5-3.5 m ³ (mjet teknologjik)	2 cope	Pronësi ose me qira
7	Mini damper kapacitet mbajtës 4-5 ton për transport të dherave (mjet teknologjik)	1 cope	Pronësi ose me qira
Pajisje Teknike			
1	Turiel për hapje gropa të shtyllave	1 cope	Pronësi ose me qira
2	Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e kablove	2 cope	Pronësi ose me qira
3	Kit komplet veglash pune dhe aparate për specialist linje	1 cope	Pronësi ose me qira
4	Kokore	17 cope	Pronësi ose me qira
5	Komplet i ndihmës së shpejt	2 cope	Pronësi ose me qira
6	Tabela paralajmëruese për sigurimin e perimetrit kantier	10 cope	Pronësi ose me qira
7	Set veglash për kablo TM (prerëse kabli, Bombul me Kanello)	1 cope	Pronësi ose me qira

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

- a. *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; certifikate transporti, certifikatë e kontrollit teknik; siguracion mjeti, (i vlefshëm).*
- b. *Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) leje qarkullimi; certifikatën e kontrollit teknik; certifikate transporti siguracion mjeti (i vlefshëm);*
- c. *Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.*
- d. *Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.*
- e. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën 8 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.*
- f. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaronte se mjetet dhe pajisjet*

e deklaruara sipas shtojcës 8 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

- g. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronësi ose me qira me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor gjate procesit te vlerësimit te ofertave.*

Argumentimi: *Kërkesa për disponimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve teknike është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6, geramat “ç” dhe “d”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të cilat parashikojnë që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë kapacitetet teknike dhe logjistike të nevojshme për realizimin e kontratës. Objekti i kontratës “Ndërtim linje furnizimi me ujë dhe energji për Qendrën e Kafshëve të Rrugës” përfshin procese pune që kërkojnë përdorimin e mjeteve të specializuara për gërmime dhe sistemime terreni, transport materialesh dhe elementësh ndërtimorë, vendosje shtyllash dhe instalime elektrike, prodhim dhe hedhje betony, shtrirje dhe montim kabllorsh. Në këtë kuadër:*

Mjetet e transportit dhe ngritjes (kamionë, autovinç, kamion me vinç, kamioncina) janë të domosdoshme për transportin e materialeve, shtyllave dhe pajisjeve, si dhe për montimin e elementëve në terren.

Eskavatori dhe mini damperi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të gërmimit, hapjes së kanaleve dhe transportit të dherave, procese thelbësore për vendosjen e linjave të ujit dhe energjisë.

Autobetonieret vetëngarkuese sigurojnë realizimin e punimeve të betonimit në kushte efikase dhe në përputhje me specifikimet teknike.

Pajisjet teknike (turiel për gropa, set karrukullash për kabllor, vegla pune, pajisje sigurie, etj.) janë të domosdoshme për realizimin e proceseve specifike të instalimit dhe për garantimin e sigurisë në kantier.

Numri dhe lloji i mjeteve/pajisjeve janë përcaktuar mbi bazën e analizës së projektit dhe preventivit të punimeve, në referencë të VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, duke marrë në konsideratë volumet e punës dhe afatin e realizimit. Kërkesa që mjetet të jenë në pronësi ose me qira nuk kufizon konkurrencën, pasi u jep mundësi operatorëve ekonomikë të disponojnë kapacitetet e nevojshme edhe përmes kontratave të qirasë. Gjithashtu, kërkesat për dokumentacionin shoqëruar (akte pronësie, leje qarkullimi, certifikata teknike, kontrata qiraje, etj.), si dhe deklaratat për disponueshmërinë dhe verifikimin e mjeteve synojnë të garantojnë ekzistencën reale dhe funksionale të tyre, shmangin deklaratimet fiktive, sigurojnë që mjetet nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë zbatimit. Në përfundim, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, proporcional me volumet dhe kompleksitetin e kontratës dhe i domosdoshëm për garantimin e realizimit në kohë, me cilësi dhe sipas standardeve teknike.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata

- a. ISO 9001:2015 - “Sistemi i Menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme, ose ekuivalente
- b. ISO 45001:2018- “Sistemi i menaxhimit te sigurisë dhe shëndetit ne vendet e punës”, e vlefshme, ose ekuivalente.
- c. ISO 14001:2015- “Sistemet e menaxhimit te ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente.
- d. ISO 39001:2012- “Sistemet e menaxhimit te sigurisë” e vlefshme, ose ekuivalente.
- e. ISO 50001:2011- “Standard për Sistemin e Menaxhimit te Energjisë”, e vlefshme, ose ekuivalente.

Te gjitha certifikata e mësipërme duhet te jene te të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga

Republika e Shqipërisë. Certifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme.

Ne zbatim te nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021, i ndryshuar, autoriteti pranon çdo certifikate ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.”

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

2.4.2 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqes grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi: *Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”*

Grupi i hartimit te specifikimeve referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar nga projektuesi ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 4 (katër) javë nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi te gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.4.3 Në mënyrë qe te krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për mallrat e mëposhtëm:

- a. Kabell ABC 4 x 70
- b. Kabell ABC 4 x 50
- c. Kabell ABC 4 x 35
- d. Kabell ABC 4 x 25
- e. Kabell XLPE 4 x 70

Operatori ekonomik duhet te paraqesë:

1. Autorizim te prodhuesit/të distributorëve të autorizuar për listën e mësipërme te mallrave. Autorizimi duhet te përmbajë te dhëna te plota te prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e- mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Shënim: *Operatori ekonomik /Bashkimi i operatoreve, duhet te ofertoje vetëm me një prodhues për secilin*

artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose me shume prodhues për te njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikohet nga procedura.

2. Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojnë lehtësisht dhe qarte qe janë pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë dëshmi te testimave zyrtare te kryera, të lëshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve te prodhuara (lista mësipërme e materialeve) me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke respektuar parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë. Specifikimet teknike janë formuluar në mënyrë të tillë që të përshkruajnë qartë karakteristikat funksionale dhe teknike të mallrave/ punimeve që kërkohen, pa kufizuar konkurrencën dhe pa favorizuar prodhues apo marka të caktuara. Gjithashtu, kërkesat për certifikime, teste dhe parametra teknike janë të domosdoshme për të siguruar që produktet dhe materialet e ofruara të jenë në përputhje me standardet e kërkuara dhe të garantojnë qëndrueshmëri, funksionalitet dhe siguri në përdorim . Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtim orë kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Në çdo kërkesë te preventivit ku është shënuar marka e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”. Në specifikimet teknike, AK i është referuar standardeve ndërkombëtare EN, fakti që ekzistojnë standard ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, vlerësojmë që për standardet e mësipërme, ne si AK pranojmë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit european dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të komformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike dhe relacioni, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit







•